

RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT	
EMERTIMI I PROPOZIMIT TE POLITIKES	Projektligj “Per disa ndryshime ne ligjin nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar
MINISTRIA UDHEHEQESE	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)
FAZA E POLITIKES/VLERESIMIT TE NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TE POLITIKES	I brendshem
DIREKTIVE/RREGULLORE E BE-se	Ndryshimet e propozuara ne projekt aktin nuk transpozojne akte te Bashkimit Evropian. Ndryshimet e ligjit dhe ndryshimet ne Shtojcen I te tij, nuk i prekin kerkesat e direktives 2010/75/EU “Per shkarkimet industriale” per lejet e mjedisit te tipit A dhe i qendrojne strikt asaj.
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITE E LIDHURA	Nuk ka
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	09.10.2019
DATA E VLERESIMIT TE NDIKIMIT	07.10.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERESIMIN E NDIKIMIT? NESE PO, JEPNI DATEN E SHQYRTIMIT	Jo
NUMRI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT	2019 – MTM- Nr. 00
TE DHENA KONTAKTI <i>(emri, e-mail, numri i telefonit te personit te kontaktit)</i>	Ornela Shoshi e-mail-i: ornela.shoshi@turizmi.gov.al numri i telefonit: 0698137888
PJESA 1: PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE <i>(Maksimumi 2 faqe)</i>	
<p>PERKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili eshte problemi ne shqyrtim dhe cilat jane shkaqet e tij? Pse eshte e nevojshme nderhyrja qeverise?</i></p> <p>Eshte kosntatuar se nga zbatimi ne praktike i ligjit per lejet e mjedisit, rezulton se aktivitet qe kane ndikimin te ulet ne mjedis kane dhe nivel tei shkarkimeve ne mjedis gjate operimit te tyre te pallogaritshem. E pare ne kete kendveshtrim,nga konsultimet e kryera midis MTM me AKM me pushtetin vendor dhe aktoret e perfshire ne kete proces, u konkludua te mos jete me nevoja qe keto aktivitete qe kane nje ndikim te ulet ne mjedis, te mos pajisen me me leje mjedisi te tipit C, pasi i sjell qytetareve dhe subjekteve humbje kohe dhe kosto per per pajisjen me kete leje.</p> <p>Pushteti qendror nuk mund te angazhohet me per te pajisur me leje mjedisi te tipit C aktivitetet, ndikimi i te cilave ne mjedis eshte teper minimal, nderkohe qe fokusi i ministrise pergjegjese per mjedisin dhe institucioneve te saj te varesise eshte kontrolli dhe monitorimi i aktiviteteve qe sjellin ndotes te medhenj industriale, te cilet ndikojne ne cilesine e trupave uJOR, cilesine e ajrit, si dhe kontaminimin e tokes dhe ujerave nentokesore. Nevoja per ndryshim te ligjit eshte rrjedhoje edhe e debatit publik mes grupeve te interesuara dhe institucioneve politike.</p>	
<p>OBJEKTIVAT <i>Cilat jane objektivat dhe efektet e synuara te propozimit?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • nderhyrja dhe ndryshimi i ndjeshem ne sistemin ekzistues telejeve te mjedisit, duke e ndryshuar ate nga nje sistem prej tri nivelesh te lejeve te mjedisit, tipi A, B apo C, ne nje sistem vetem me dy nivele te lejeve te mjedisit, perkatesisht leje te tipit A dhe B, duke hequr keshtu lejet e mjedisit te tipit C; • rritjen e kontrolleve nga ministria pergjegjese per mjedisin dhe institucioneve te saj te 	

varesise ndaj operatoreve (aktiviteteve) te pajisur me leje mjedisi te tipit A dhe B;

- garantimin e sherbimeve cilesore dhe shqyrtim i detajuar nga ministria pergjegjese per mjedisin dhe institucioneve te saj te varesise per aplikimet per leje mjedisi te tipit A dhe B.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat jane opsionet kryesore te politikave, duke perfshire menytrat ndaj rregullimit? Duhet te beni krahasimin e avantazheve/perfitimeve kryesore dhe te dizavantazheve/kostove te opsioneve te mundshme. Duhet te percaktoni detajet ne lidhje me opsionin e preferuar.

Per arritjen e objektivave, jane shqyrtuar opsionet e meposhtme:

- **Opsioni 0 (status quo):** nuk do te nderhyjme me ndryshim apo ligj te ri;
- **Opsioni 1:** ndryshim i ligjit ekzistues (ligjin nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar);
- **Opsioni 2:** Hartimi/miratimi i ligjit te ri “Per lejet e mjedisit”.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat jane ndikimet e opsionit te preferuar? Kjo duhet te perfshije ndikimet me vlere monetare te percaktuar dhe ndikimet pa vlere monetare te percaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike te opsionit te preferuar do te perfshijne uljen e kostove per biznesin, te cilet paguanin 2000 (dymije) leke ne vit per ministrine per lejen e tipit C dhe tarifen prej 10.000 lekesh ne momentin e aplikimit per kete leje. Kostot e drejtperdrejta per biznesin e vogel dhe te mesem do te shoqerohen me heqjen e tarifes prej 10.000 (dhjetemije) lekesh per t'u pajisur me leje mjedisi te tipit C dhe koston vjetore prej 2.000 lekesh. Kjo iniciative do te sjellethjeshtimin e punes se administrates, prado te sjelle disa lloje ndikimesh jo te drejtperdrejta ekonomike te mundshme, si pasoje e heqjes se lejes se mjedisit te tipit C, ku stafi i ministrise pergjegjese per mjedisin dhe institucioneve te saj te varesise, te cilet paguhen nga buxheti i shtetit, tani do te fokusohen vetem ne shqyrtimin e aplikimeve te lejeve te mjedisit te tipit A dhe B dhe kontrollin e zbatimit te kushteve per mbrojtjen e mjedisit nga keta operatore, nga ndotesit te medhenj industriale, te cilet do te ndikojne ne permiresimin e cilesise e trupave uxor, cilesine e ajrit, si dhe kontaminimin e tokes dhe ujerave nentokesore. Kjo gje do te sjelle permiresim te cilesise se mjedisit duke minimizuar ndotjen e shkaktuar nga ushtrimi i aktiviteteve industriale, ulje te ndikimeve te demshme ne shendetin e njeriut si dhe rritje te turizmit ne Shqiperi. **Ndikimi mjedisor i drejtperdrejte kryesor:** Me permiresimin e cilesise se mjedisit dhe minimizimin e ndotjes se shkaktuar nga ndotesit e medhenj industriale, do te kemi nje rritje te larmise biologjike ne Republiken e Shqiperise dhe permiresim te cilesise se habitateve natyrore; Permiresimin e cilesise se trupave uxor, cilesise se ajrit, si dhe ulje te kontaminimit te tokes dhe ujerave nentokesore Politika gjithashtu mund te sjelle edhe disa ndikime mjedisore jo te drejtperdrejta, duke perfshire sa me poshte vijon: krijimi i mundesive per zhvillimet e eko-turizmit, si dhe eshte identifikuar si **ndikim social jo i drejtperdrejte** permiresimi i cilesise se jetes ne qendrat urbane dhe rurale ku zhvillohen aktivitet industriale si dhe rritja e vendeve atraktive per turistet dhe vizitoret.

ARSYETIMI I OPSIONIT TE PREFERUAR

Shpjegoni arsyet per zgjedhjen e opsionit te preferuar. Ju lutemi jepni nese eshte e mundur koston dhe perfitimin me vlere te percaktuar monetare.

Opsioni i preferuar eshte perzgjedhur Opsioni 1, ndryshimi i ligjit nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar, duke u nisur nga analiza e vleresimit te boshlleqeve ligjore, nepermjet te cilit u identifikuan nderhyrjet qe duheshin bere. Nisur edhe ngainterestat e ndryshme qe preken dhe cilat do te jene kostot e zbatimit te ligjit te ri per sektorin publik dhe ate privat, eshte vleresuar rishikimi i ligjit ekzistues, pasi ndryshimet e propozuara nuk perbejne me shume se 50% te dispozitave te ligjit, madje preken shume pak pika te neneve te ligjit ekzistues. Gjithashtu, kur ndryshimet jane te tilla qe nuk prekin thelbin e ligjit, por rregullojne disa aspekte te tij, eshte me eficente qe te behen ndryshime ne ligjin ekzistues dhe jo hartimi i nje ligji te ri.

Kostoja e perlllogaritur ne total e opsionit te preferuar mbi buxhetin e shtetit gjate periudhes 3-vjeçare menjehere pas miratimit te ligjit (kostoja ne total ne lek, çmimet aktuale, ne terma nominale):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
19,139	17,849	17,849

KONSULTIMI

Jepni nje permbledhje te çdo konsultimi te kryer (me ke dhe si jeni konsultuar?), çfare pikepamjesh jane shprehur, si jane trajtuar ato, domethene çfare ndryshimesh jane pranuar dhe çfare jane refuzuar dhe arsyt pse?)

MTM ne bashkepunim me AKM, ka kryer tre takime teknike-konsultative te grupit te punes. Ne perfundim te ketij procesi konsultativ, grupi i punes ka percjelle prane MTM-se draft ligjin per ndryshimin e ligjit ekzistues per lejet e mjedisit.

Me date 08.10.2019 projektligji “Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 10448, date 23.10.2008 “Per lejet e mjedisit” te ndryshuar se bashku me dokumentacionin shoqerues jane publikuar per konsultim publik ne Regjistrin elektronik te Konsultimit Publik ne eebsite

<http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/218>, si dhe <http://www.mjedisi.gov.al>.

Gjithashtu eshte kryer takimi i konsultimit publik, me te gjitha grupet e interesit me date 09.10.2019. Gjate takimit u diskutuan te gjitha nenet e projektligjit, per te cilat u ra parimisht dakord, me disa sugjerime sa i takon perkufizimeve, te cilat jane trajtuar ne projektligj

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do te organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi do te realizohen sipas percaktimeve te dispozitave te projektligjit per lejet e mjedisit, si dhe me miratimin e akteve nenligjore qe do te miratohen ne zbatim te ketij ligji.

Bashkite, Agjencia Kombetare e Mjedisit dhe struktura inspektuese per mjedisin ne AKM do te bashkepunojne per te kryer kete proces (menaxhimin dhe monitorimin e shkarkimeve industriale nga instalimet industriale), ndersa Ministria pergjegjese per mjedisin do te monitoroje ne vijimesi procesin (menaxhimin dhe monitorimin e shkarkimeve industriale nga instalimet industriale), do te analizoje raportet dhe gjetjet e rekomandimet kryesore te tyre, si dhe do t'i perdore ato per hartimin/rishikimin ne kuader te permiresimit te politikave per menaxhimin dhe monitorimin e shkarkimeve industriale nga instalimet industriale.

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ne progres-raportin e fundit të BE-se për Shqipërinë theksohet: Lejet nuk janë plotësisht të përputhura me të gjitha kërkesat ligjore dhe nuk ka një monitorim të pavarur të ndotjes industriale. Të dhënat e kufizuara për ndotjen industriale mbështeten në vetë-monitorimin dhe deklarinimin e ndermarrjeve. Kapaciteti zbatues i inspektoratit të mjedisit është shumë i kufizuar.

Pas përfundimit të vlerësimit të pajtueshmërisë së këtyre ligjeve me kuadrin ligjor të BE-se, behen rekomandime për procesin e rishikimit të këtyre ligjeve kombëtare në mënyrë që të përcaktohet nëse ka nevojë të ndryshohet ose të hartohet akti i ri ligjor i legjislacionit që rregullon monitorimin e shkarkimeve industriale.

Ndaj u konkludua se institucionet qendrore nuk mund të angazhohen për të leshuar me leje mjedisi të tipit C për aktivitete, ndikimi i të cilave është tepër minimal në mjedis, nderkohe që fokusi i ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe institucioneve të saj të varesisë është kontrolli dhe monitorimi i ndotesve të ngjashmërisë industriale, të cilët ndikojnë në cilësinë e trupave ujorë, cilësinë e ajrit, si dhe kontaminimin e tokës dhe ujërave nëntokësore, duke sjellë edhe dëm të shëndetit të njeriut.

Problemi në shqyrtim

- *Përkrahësi natyror i problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përkrahësi shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetaret.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemi lidhet me monitorimin e ndotjes dhe shkarkimeve të ndotesve nga industria, si pasojë e mos koordinimit ndër-institucional dhe nivelit të ulët të sistemit të monitorimit.

Pavarësisht përmirësimeve që ka sjellë zbatimi i ligjit të lejeve të mjedisit, prapë Shqipëria haset me shkarkimet endotesve në mjedis dhe mos menaxhimin e duhur të mbetjeve që gjenerohen nga instalimet industriale.

Shkaqet kryesore të këtij problemi janë:

- Buxheti i ulët për monitorimin e situatës;
- Mbivendosje e fushave të përgjegjësisë midis institucioneve;

Problemi i shkarkimit të ndotesve nga instalimet e mëdha industriale është në nivel kombëtar, pra prek të gjithë sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë, kryesisht zonat urbane.

Grupet e interesit të prekura nga ky problem janë: Qeveria (Bashki, MTM, AKM)/ biznesi (eko-turizmi)/ shoqëria civile (shoqata për mbrojtjen e biodiversitetit, shkencëtarë)/ qytetaret (vizitorë, turistë) pra, grupet e interesit të prekura përfshijnë institucionet e varesisë së Ministrisë përgjegjëse për mjedisin, Bashkitë dhe OJF-të mjedisore të specializuara në fushën e ndotjes industriale.

Arsyeja e nderhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon te nderhyje dhe pse eshte e nevojshme.*
- *Shpjegoni se cfare shpreson te trajtoje qeveria nepermjet kesaj nderhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallen e nderhyrjes se qeverise qe nevojitet per te trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbeshtet kjo nderhyrje objektivat e nivelit te larte te qeverise.*
- *Rendisni punen ekzistuese qe eshte realizuar tashme.*

Ne pergjithesi, detyrimet kryesore per parandalimin, kontrollin dhe monitorimin e shkarkimeve industriale nga operatoret e medhenj dhe te mesem industriale jane transpozuar ne menyre efektive ne legjislacionin shqiptar. Megjithate, jane identifikuar disa mungesa te rendesishme dhe kuadri i aplikueshem ligjor mbetet i paqarte ne lidhje me masat specifike ligjore per shkak te fragmentimit te rregullave ose perseritjes dhe mbivendosjes se dispozitave perkatese. Prandaj nuk eshte gjithmone e qarte se cili eshte legjislacioni i zbatueshem, gjithashtu edhe disa aspekte te legjislacionit te BE nuk mbulohen.

Nga sa me siper, vleresohet se eshte i nevojshem ndryshimi i ligjit ekzistues per shkarkimet industriale, me qellim:

- a) permbushjen e rekomandimeve te BE dhe hartimin e politikave me te plota, bazuar ne te dhena konkrete dhe shkencore;
- b) Zbatimin e rekomandimeve te progres raporteve te viteve te fundit te BE-se per Shqiperine per te arritur peraftrimin e plote ne fushen e shkarkimeve industriale, duke u fokusuar ne instalimet e medha dhe te mesme industriale;
- c) Percaktimin qarte te institucioneve pergjegjese per menaxhimin dhe monitorimin e shkarkimeve industriale nga instalimet e medha dhe te mesme industriale dhe per te shmangur mbivendosjet ne kete proces, duke u perqasur me reformat e ndermarra nga qeveria se fundmi, per ristrukturimin e inspektoriatit shteteror te mjedisit, pyjeve, ujerave dhe turizmit, duke i kaluar kompetencat inspektuese AKM-se persa i perket mjedisit dhe ujerave.

Kjo nderhyrje lidhet me objektivin e Qeverise se Shqiperise drejt permbushjes se kriterëve per hapjen e negociatave per anetaresim ne BE, duke synuar peraftrimin e plote te legjislacionit kombetar me direktiven perkatese te paraqitura ne nivel kombetar ne Planin Kombetar te Integritimit Evropian. Gjithashtu, rishikimi i ligjit te lejeve te mjedisit eshte nje proces mjaft i rendesishem dhe ne kuader te reformes antikorrupsion dhe lehtesimit te procedurave per keto biznese, kryesisht te vogla, me nje ndikim te ulet ne mjedis.

Aktualisht Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ne bashkepunim me AKM ka hartuar nje raport mbi analizen e legjislacionit aktual shqiptar per shkarkimet industriale, perputhshmerine e tij me legjislacionin e BE-se ne kete fushe, si dhe eshte hartuar, projektligji “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 10448, date 14.7. 2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva qe korrespondojne me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni qe objektivat jane specifike, te matshem, te arritshem, reale dhe ne kohe.*

Kjo politike e propozuar synon permbushjen e objektivave te meposhtme:

- Permiresimi dhe forcimi i detyrimeve qe lidhen me parandalimin, kontrollin dhe monitorimin e shkarkimeve industriale nga operatoret e medhenj dhe te mesem industriale ne Shqiperi;
- Percaktimi i organeve ne nivel lokal/vendor, qe do te ngarkohen per parandalimin, kontrollin dhe monitorimin e shkarkimeve industriale nga operatoret e medhenj dhe te mesem industriale ne vend;
- Ndarja e qarte e pergjegjesive midis organeve qe do te ngarkohen me parandalimin, kontrollin dhe monitorimin e shkarkimeve industriale nga operatoret e medhenj dhe te mesem industriale dhe Agjencise Kombetare te Mjedisit qe monitorojne shkarkimet ne mjedis.
- Permiresimi i sistemit te monitorimit dhe inspektimit per operatoret e medhenj dhe te mesem industrial.
- Permiresimi i sistemit te monitorimit dhe inspektimit nga strukturat pergjegjese te pushtetit vendor per instalimet e vogla me ndikim te ulet ne mjedis.

Pershkrimi i opsioneve te shqyrtuara

- *Pershkruani opsionin e status quo-se.*
- *Identifikoni dhe pershkruani te gjitha opsionet e politikave qe keni marre parasysh.*
- *Shpjegoni se si jane zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjate analizes qe eshte kryer nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ne bashkepunim me AKM, jane shqyrtuar tre opsionet e meposhtme:

- Opsioni i status quo-se (0): boshlleku ligjor dhe institucional dhe si pasoje moszbatimi i plote i dispozitave te ligjit ekzistues per shkak te angazhimit te institucioneve te varesise te MTM me instalimet e vogla industriale (lejet e tipit C) te cilat kane ndikim te ulet ne mjedis, pasi niveli i shkarkimeve eshte i pallogaritshem per ndikimet negative ne mjedis;

Opsioni 1: ndryshimi i ligjit ekzistues. Perkatesisht eshte rekomanduar opsioni per hartimin e kesaj politike, pra rishikimi i ligjit ekzistues per lejet e mjedisit, Nepermjet ndryshimit te ketij ligji synohet nderhyrja dhe ndryshimi i ndjeshem ne sistemin e lejeve te mjedisit, duke e ndryshuar ate nga nje sistem prej tri nivelesh te lejeve te mjedisit, tipi A, B apo C, ne nje sistem vetem me dy nivele te lejeve te mjedisit, perkatesisht leje te tipit A dhe B, duke hequr keshtu lejet e mjedisit te tipit C. Ndryshimi i propozuar do te shoqerohet me rishikimin e aktiviteteve qe ndikojne ne mjedis, konkretisht ne sakesimin e listes se veprimtarive te Shtojces I te ligjit Nr. 10448, date 14.07.2014 "Per lejet e mjedisit" te ndryshuar. Ne ndryshim nga lista ekzistuese ne Shtojcen I, kjo shtojce e re i ndan ne menyre te qarte dhe bashkekohore aktivitetet ne baze te madhesis dhe kapacitetit te veprimtarise, ne instalime industriale te tipit A dhe B.

Kjo nderhyrje ne sistemin e lejeve te mjedisit shoqerohet gjithashtu edhe me riklasifikimin e disa aktiviteteve te tjera si aktivitete qe kane nevoje per paisjen me leje te tipit B. Aktualisht, sipas percaktimeve ne kuadrin ligjor ne fuqi keto aktivitetet

klasifikohen si veprimtari që duhet të pajisen me leje mjedisit të tipit C, por për efekt të ndikimit të tyre me të ndjeshëm në mjedis, shkaktuar nga shkarkimet gjate operativitetit, do të rikategorizohen si instalime që duhet të pajisen me leje mjedisi të tipit B.

Ndryshimet e propozuara lehtësojnë ndjeshëm, si në kohë, por mbi të gjitha në koston financiare subjektet që tashmë operojnë me një leje mjedisi (tipi C), pasi ato lirohen nga tarifa vjetore e lejes së mjedisit, por dhe kosto dhe tarifa e përgatitjes së raporteve për zbatueshmërinë e kushteve të lejes së mjedisit të tipit C (një ose dy here në vit). Gjithashtu, është një proces i rëndësishëm dhe në kuadër të reformës antikorrupsion dhe lehtësimin e procedurave për këto biznese, kryesisht të vogla, me një ndikim të ulët në mjedis.

Konkretisht nga sistemi i pajisjes me leje mjedisi të tipit C hiqet detyrimi për t'u pajisur me leje mjedisi të tipit C për 49 aktivitete ekonomike, dhe nga ky ndryshim përfitojnë rreth 6900 operatorë/biznese, të cilët nuk kanë me detyrimin të pajisen me leje mjedisi të tipit C, nuk paguajnë me tarifen vjetore prej 2000 leke dhe nuk kanë me detyrimin e dorezimit të raporteve për zbatueshmërinë e kushteve të lejes së mjedisit të tipit C (një ose dy here në vit), e cila ka një kosto të konsiderueshme për bizneset e vogla.

Për aktivitetet si, pikat e karburanteve, furra buke, gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore (restorante), magazinimi frigoriferik, depot farmaceutike, apo Larje dhe pastrim mjeteve motorike (lavazhet), nuk kanë me detyrim të pajisen me leje mjedisi.

Ndërsa aktivitetet e tjera që në varesi të kapacitetin pajiseshin me leje mjedisi të tipit B apo C, i është hequr detyrimi që të pajisen me leje mjedisi tipi C nën kapacitetin e parashikuar për leje mjedisi të tipit B.

Me reflektimin e tyre në ligjin ekzistues të vitit 2011 u pa që ndryshimet e bëra nuk përbenin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit, kështu që u konkludua që opsioni që do të zgjidhej ishte rishikimi i ligjit dhe jo hartimi i një ligji të ri.

- Opsioni 2: ligj i ri për lejet e mjedisit. Përafrimi i plote i direktives dhe Përcaktimi i organeve që do të menaxhojnë dhe monitorojnë shkarkimet industriale nga operatorët industrialë në vend, por do të sillte zgjatjen e procedurave për hartimin dhe miratimin e tij, si dhe do të prekte edhe çështje që nuk është e nevojshme të nderhyhet në këto momente.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtperdrejta dhe jo të drejtperdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtperdrejta:*
 - *Përkrahësi nga ana e cilesore ndikimet e drejtperdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana e sasiore ndikimet me të rëndësishme të drejtperdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve me të rëndësishme të drejtperdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndermarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtperdrejta:*
 - *Përkrahësi nga ana e cilesore ndikimet jo të drejtperdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*

- *Jepni supozimet ne te cilat jane bazuar parashikimet dhe risqet, te cilave ato u nenshtrohen.*
- *Tregoni sa te forta, te pavarura dhe te rendesishme jane provat qe mbeshtesin supozimet.*
- *Tregoni se cfare mund te pengoje realizimin e perfitimeve, te rrise kostot ose te sjelle pasoja te papritura.*
- *Permbledhni vleresimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni nje pasqyre permbledhese te te gjitha ndikimeve te opsioneve te analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e te gjitha opsioneve te analizuara krahasohen me njera-tjetren.*
 - *Paraqisni perlogaritjet me te mira te pergjithshme neto te ndikimit me vlere monetare te percaktuar per cdo opsion (shih aneksin 1/b per tabelen qe mund te perdorni).*

Per efekt te ketij vleresimi te ndikimit dhe ne mungese te politikës, ne supozojme se shkarkimet industriale nga operatorët e medhenj dhe te mesem industriale ne Republiken e Shqiperise nuk do te menaxhohen dhe monitorohen si duhet, nuk do te kete nje sistem cilesor te monitorimit, si dhe nuk do te merren masat e duhura per parandalimin e ndotjes industriale, ne rast se nuk kryejme nderhyrjet e duhura ligjore.

Opsioni 1, i propozuar per ndryshimin e ligjit ekzistues prek grupet e meposhtme:

- AKM,
- Bashkite,
- si dhe komunitetin.

Ndikimet konsistojne ne ndarjen/transferimin e pergjegjesive konkrete dhe luajtjen e rolit nga secili prej tyre ne menyre te mire percaktuar.

Opsioni i perzgjedhur nuk ka ndikime jo te drejtperdrejta mbi konkurrencen.

Ndikimet ekonomike

- Ky propozim nuk do te sjelle rritje te fondeve shtese nga buxheti i shtetit
- Kostot ne buxhetin e shtetit do te ekzistojne:
 - Sistemit te monitorimit te shkarkimeve industriale, por tani me do te fokusohet ne shkarkimet industriale nga operatorët e medhenj dhe te mesem industriale
 - Rritje e stafit ekzistues ne MTM dhe institucionet e varesise, si dhe ne njesite e qeverisjes vendore;
- Kostot e vazhdueshme ekziston dhe qe lidhen me:
 - Mbarevajtjen e sistemit te monitorimit te shkarkimeve industriale nga operatorët e medhenj dhe te mesem industriale
 - Mbledhjen dhe perpunimin e te dhenave te perftuara nga monitorimi i shkarkimeve industriale nga operatorët e medhenj dhe te mesem industriale
 - Kryerjen e vizitave ne terren nga stafi i AKM-se dhe deget rajonale
- Kostot operacionale te monitorimit te shkarkimeve industriale nga operatorët e medhenj dhe te mesem industriale, si dhe inspektimet ne terren nuk mund te percaktohen tani, pasi do te percaktohen ne akte nenligjore qe do te miratohen ne zbatim te ketij ligji.

Ndikimet mjedisore

Rritje e cilesise se mjedisit ne Republiken e Shqiperise dhe permiresimi i cilesise se habitateve natyrore si pasoje e minimizimit te ndotjes nga shkarkimet industriale nga operatorët e medhenj dhe te mesem industriale do te sjelle rrjedhimisht ndikim pozitiv ne mjedis. Pra ndikimi ne mjedis eshte i drejtperdrejte dhe perfshin:

- Permiresimin e cilesise te perbereseve te mjedisit, uje, ajer, toke, biodiversitet.

- Permiresimi i habitateve natyrore.

Ndikimet sociale:

- Shtimi i bizneseve te eko-turizmit (biznese miqesore ndaj mjedisit)
- Shtim i vizitoreve ne zonat me vlera te larta natyrore.

Opsionet e vleresuara nga grupi teknik i punes ne bashkepunim u kryen duke analizuar numrin e dispozitave dhe neneve qe ndryshohen dhe shtohen per te arritur qellimet/objektivat e ketij projektakti. Krahasimi eshte bere duke u nisur nga numri total i neneve te projektligjit ekzistues dhe nenet qe ndryshohen dhe shtohen. Ne perfundim u arrit ne konkluzionin qe paraqitja e projektaktit te jete ne formen e projektligjit “Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 10448, date 14.7. 2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

Arsyetimi i opsionit te preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar ne analize.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Kriteret qe tregojne arritjen e objektivit per ndryshimin e sistemit te lejeve te mjedisit ne vend:

- **Reduktimi i risqeve dhe ndotjes qe shkaktohet nga keq menaxhimi i shkarkimeve industriale:**
- **Adresimi i menaxhimit te integruar te mbetjeve industriale si çeshtje ekonomike, sociale dhe mjedisore**
- **Permireson koordinimin nderisntitucional, monitorimin dhe raportimit**
- **Permireson qasjen ne financimin e veprimeve per parandalimin, kontrollin dhe monitorimin e shkarkimeve industriale nga operatoret e medhenj dhe te mesem industriale**

Matrica e performances

<i>Kriteret</i>	<i>Pesha</i>	<i>Opsioni 0</i> (nuk do te kete ndryshim /politike te re)	<i>Opsioni 1</i> (Hartimi i aktit ligjor per ndryshimin e ligjit ekzistues)	<i>Opsioni 2</i> hartimi i nje ligji te ri
<i>Efektivitet ne Reduktimin e risqeve dhe ndotjes qe shkaktohet nga keq menaxhimi i shkarkimeve industriale</i>	5	1 (5)	4 (20)	2 (10)
<i>Aftesia per te adresuar menaxhimin adeguat te mbetjeve industriale si çeshtje ekonomike, sociale dhe mjedisore</i>	3	1 (3)	3 (9)	2 (6)
<i>Aftesia per te permiresuar koordinimin nderisntitucional, monitorimin dhe raportimit</i>	3	1 (3)	2 (6)	1 (3)
<i>Aftesia per te permiresuar qasjen ne financimin e veprimeve per parandalimin, kontrollin dhe monitorimin e shkarkimeve industriale nga operatoret e medhenj dhe te mesem industriale</i>	4	1 (4)	3 (12)	1 (4)
<i>Kostot</i>	3	3 (9)	1 (3)	2 (6)
<i>Piket</i>		24	50	29

Opsioni i preferuar eshte hartimi dhe miratimi i projektligjit “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. nr. 10448, date 14.7. 2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar” pasi bazuar ne analizen e dispozitave dhe neneve qe ndryshohen/shtohen u arrit ne perfundimin se nuk eshte e nevojshme te hartohet nje ligji i ri, pasanalizes se bere te vleresimit te mangesive ligjore, nepermjet te cilit u identifikuan nderhyrjet qe duheshin bere. Me reflektimin e tyre ne ligjin ekzistues te vitit 2011 u pa qe ndryshimet e bera nuk perbenin me shume se 50% te dispozitave te ligjit, keshtu qe u konkludua qe opsioni qe do te zgjidhej ishte rishikimi i ligjit dhe jo hartimi i nje ligji te ri.

Çeshtje te zbatimit

- *Shpjegoni se cila njesi do te jete pergjegjese per zbatimin e opsionit te zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme per zbatimin e opsionit te zgjedhur.*
- *Pershkruani masat qe do te ndermerren gjate zbatimit per te arritur qellimet e politikës.*
- *Specifikoni te gjitha kerkesat e perputhshmerise dhe te zbatimit.*

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, se bashku me institucionet e saj te varesise, eshte njesia pergjegjese per monitorimin e zbatueshmerise se tij, pas miratimit te ketij propozimi.

Pengesat e mundshme mund te hasen ne percaktimin e sistemit te monitorimit te shkarkimeve industriale nga operatorët e medhenj dhe te mesem industriale, kryesisht ne zbatimin e ketij sistemi monitorimi.

Gjate zbatimit te projektligjit te propozuar per te arritur qellimet e politikës, do te ndermerren masat e meposhtme:

- a) Vleresimi i gjendjes se instalimeve te medha e te mesme industriale ne Shqiperi dhe monitorimi i kesaj gjendjeje;
- b) Sigurimi i nje kuadri per perdorimin e qendrueshem te burimeve natyrore nga instalimet industriale, per te miren e gjeneratave te sotme dhe te ardhshme, pa degradimin e habitateve dhe shqetesime ndaj llojeve qe te ndikojne ne statusin e tyre te favorshem te ruajtjes;
- c) Kontribuimi ne konservimin e gjendjes natyrore te tokes, ne konservimin e cilesise, sasise dhe disponueshmerise se ujit, mirembajtjen e atmosferes, prodhimin e oksigjenit dhe mirembajtjen e klimes;

Faza e shqyrtimit/vleresimit

- *Jepni nje pershkrim te permbledhur te masave te monitorimit dhe te vleresimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit per te matur arritjen e qellimeve ose progresin drejt tyre.*

Treguesit per matjen e qellimeve konsistojne ne shkarkimeve industriale nga operatorët e medhenj dhe te mesem industriale dhe hartimin e raporteve periodike vjetore per nivelin e shkarkimeve industriale, si dhe vleresimin e ndikimeve ne mjedisi te shkaktuara nga keto shkarkimeve ne rastet kur jane mbi normat e lejuara te miratuara ne legjislacionin sektorial.

Treguesit per te matur arritjen e qellimeve te politikës per lejet e mjedisit / shkarkimet industriale jane si me poshte:

- Vleresimi dhe verifikimi i raporteve te vet-monitorimit te paraqitur periodikisht nga operatorët e te instalimeve te medha dhe te mesme industriale;

- Krijimi dhe administrimi i regjistrit të instalimeve të mëdha dhe të mesme industriale;
- Hartimi i planeve të nderhyrjes e të veprimave për përballimin e ndikimeve negative nga ndryshimet klimatike në instalime, në veçanti;
- Shtimi i kontrolleve ndaj instalimeve të mëdha dhe të mesme industriale (lejet e tipit A dhe B);
- Përmirësimi i cilësive të parametrave mjedisore në zotësi industriale dhe urbane (Uje, Ajer, toke);

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milione lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-ne.

OPSIONI 1:

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.000000	0.952835	0.907894	0.865073	0.824271	0.785394	0.748351	0.713055	0.679423	0.647378
Kosto për buxhetin – njeherë (kosto për stafin për projektligjin-paga)	1290									
Kosto për buxhetin – në vazhdim		17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849
Kosto për biznesin – njeherë	17,849									
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njeherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	19,139	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim	17,849									
Përfitimi për biznesin – njeherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim		17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849
Përfitimi për grupet e tjera – njeherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Përfitim për buxhetin – në vazhdim *										
Përfitimi në total	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849	17,849
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total	179,780									
Vlera aktuale e përfitimit në total	178,490									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total –										

Vlera aktuale e kostos ne total	
------------------------------------	--

Raporti i vleresimit te ndikimit - Shtojca2/b

Tabele: Vlera aktuale neto ne total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale ne mije leke		Vlera aktuale neto ne mije leke
	Kosto	Perfitimi	
Opsioni 1	179,780	178,490	
Opsioni 2			

Persa i perket opsionit nr. 2 ne kostot e percaktuara per opsionin numer 1 do te shtohen kosto shtese per stafin duke qene se per hartimin e nje ligji te ri nevojitet kohe me e gjate analize e perkthyer ne vlere monetare.